



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**  
**BORDI**

---

**VENDIM**

**Nr. 110, datë 25.11.2009**

**MBI**  
**MARRJEN E MASAVE ADMINISTRATIVE**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 23 të Ligji nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” dhe Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, me propozim të Departamentit të Çështjeve Juridike, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

**K O N S T A T O I S E :**

Në vazhdim të zbatimit të vendimeve të Bordit të AMF në lidhje me eliminimin e fenomenit të shitjes së policave të sigurimit Karton Jeshil për automjete me targë regjistrimi Kosovë (KS), u krye verifikim në Rregjistrin On line të shitjeve të kontratës së Kartonit Jeshil për periudhën 01.08.2009 – 07.10.2009, me objekt identifikimin e përsëritjes së shkeljeve të konstatuara më sipër .

Nga verifikimi i kryer rezulton se shoqëria e sigurimit “Sigma” sh.a, ka lëshuar 16, kontrata të sigurimit Karton Jeshil për automjete me targë regjistrimi KS.

Autoriteti më datë 12.10.2009, ka vënë në dijeni shoqërinë dhe ka kërkuar ndërprerjen e menjëhershme të lëshimit të policave Karton Jeshil për automjetet me targë regjistrimi Kosovë, si dhe informimin e menjëhershëm të Autoritetit.

Referuar Rregjistrin On line të shitjeve të kontratës së Kartonit Jeshil, rezulton se rastet më të shumta janë shitur nga punonjësi i degës Durrës, Z. Arian Bardhi.

Për sa më sipër Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

- 1. Bazuar në nenin 165, pika 1, paragrafi i parafundit, të Ligjit nr. 9267 datë 29.07.2004, të sanksionojë me gjobë në masën 300,000 lekë, punonjësën e shoqërisë “Sigma” sh.a, Z. Arian Bardhi, për shkelje të neneve 107 dhe 108, të Ligjit nr. 9267 datë 29.07.2004, për shkelje të rregullave të menaxhimit të rriskut në lidhje me shitjen e kontratave të Kartonit Jeshil mjeteve të regjistruara në Kosovë.**
- 2. Ngarkohen Departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.**

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**KRYETAR**  
**Elisabeta GJONI**